



OJQ Mundësia; rr. Vëllezërit Dragaj 4, Mitrovicë, Kosovë; +381 28 530360 / 539 576; mundesia_ngo@yahoo.com;
www.mundesia.com

**Strategjia Tri Vjeçare
2012-2015**

Përgatitur nga OJQ Mundësia
Me përkrahje nga Kristiina Mikkola - Këshilltare e Pavarur

Tabela e Përmbajtjes

1	Kush jemi ne	2
2	Sfidat momentale të zhvillimit.....	3
3	Vlerat dhe parimet tona operuese	4
4	Vizioni dhe Misioni	4
5	Grupet e Synuara dhe rajoni gjeografik.....	5
6	Çështje strategjike.....	7
7	Qëllimet strategjike dhe strategjitë thelbësore.....	8
8	Palët e Interesuara, partneritetet dhe rrjetëzimi	10
9	Analizë e Burimeve	11
10	Procesi i ri-shikimit të strategjisë.....	12

1 Kush jemi ne

OJQ Mundësia (MDA) është OJQ e regjistruar në Kosovë. OJQ Mundësia filloi si “Qendra e Grave për Trajnim dhe Këshillim” në Mitrovicë, më 2001. Deri në vitin 2006 përkrahej nga *Finnish Refugee Council* (FRC, Këshilli Finlandez i Refugjatëve, me financim nga Ministria për Punë të Jashtme të Finlandës). Që nga atëherë, OJQ-ja u zhvillua mbi konceptet e vendosura gjatë viteve të mëhershme. Ka kaluar disa ndryshime gjatë fuqizimit të vetes si një OJQ e vetë-qëndrueshme.

OJQ Mundësia operon nga qendra e vet mirë e pajisur, në pjesën jugore të Mitrovicës. Bashkë me një OJQ partnere, ajo gjithashtu udhëheq Biznes-Qendrën Rinore të Komuniteteve (*Community Business Youth Centre*) në pjesën veriore të Mitrovicës. Mundësia ka bashkëpunim të mirë me OJQ-të e grave serbe, boshnjake, rome dhe turke, që funksionojnë në Mitrovicë (jug dhe veri).

Mundësia është e ndërtuar në baza partneriteti, duke pasqyruar strukturën etnike të shoqërisë në pjesën jugore të rajonit të Mitrovicës. Të gjithë anëtarët e mundësisë janë pjesë e Asamblesë (Kuvendit) të OJQ Mundësia, e cila zgjedh Drejtorinë (Bordin) e OJQ Mundësia. Përbërja e stafit të OJQ Mundësia është shumë-etnike dhe shumë-gjuhësore. Mundësia ka zbatuar suksesshëm mbi 40 projekte qysh nga themelimi. Aty bëjnë pjesë projektet për përkrahje grave, prodhimi i artizaneve, zhvillimi dhe fuqizimi i të rinjve, zhvillimi i komuniteteve, puna me pakica si dhe projekte të paqes dhe pajtimit. OJQ Mundësia punon me një sërë organizatash donatore dhe organizata ndërkombëtare jo-qeveritare, siç është *FinnChurchAid*, *Church of Sweden*, USAID, Mercy Corps, Ambasada e Finlandës, Këshilli i Evropës, Qeveria e Belgjikës, Këshilli Danez për Refugjatë dhe UNDP. Në shtator 2011, OJQ Mundësia pranoi një çmim për kontribut për paqe nga Caritas Kosovo and Caritas Switzerland.

Që nga fillimi, OJQ Mundësia ka besuar në forcimin e lidhjeve dhe partneriteteve me organizatat ndërkombëtare dhe lokale, qeverinë dhe bizneset, për të ndihmuar qëllimet e zhvillimit të shoqërisë civile. Përmes projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme, Mundësia ka përkrahur integrimin e barazisë gjinore dhe ekonomike në të gjitha aspektet e shoqërisë kosovare duke rritur fuqizimin ekonomik dhe shoqëror të grave, posaçërisht (por jo ekskluzivisht) në qytetin e Mitrovicës dhe atë të Vushtrrisë, dhe disa nga fshatrat përreth. OJQ Mundësia ka punuar krahas, dhe në bashkëpunim me, organizatat e tjera jo-qeveritare ndërkombëtare dhe të vendit, institucionet qeveritare, bizneset, rrjetet dhe lojtarët tjerë të përshtatshëm, që punojnë në zhvillimin e shoqërisë civile, për të identifikuar financime, përkrahjen në të mira ose sponsor për projekte të cilat përfshijnë gratë, kanë ndikim pozitiv në komunitete, ose promovojnë OJQ-të e vetë-qëndrueshme. OJQ Mundësia ka organizuar dhe promovuar aktivitete dhe projekte përfshirëse të cilat inkurajojnë qëndrueshmërinë dhe zhvillimin ndër-etnik. Organizata ka përvojë për më shumë se një dekadë, nga përkrahja e kategorive më të lëndueshme të grave, siç janë gratë me nivel të ultë të edukimit, gratë refugjate të kthyer, dhe gratë kryefamiljare. Fushat e përvojës dhe ekspertizës së OJQ Mundësia përfshijnë gjithashtu prodhimin tradicional të artizaneve për gratë e vetë-punësuar, fuqizimi ndër-etnik, punësimi i të rinjve, fuqizimi i komuniteteve, ngritja e vetëdijes për çështje legale, zhvillimi shoqëror, trajnime për shkrim-lexim, promovimi i shumëllojshmërisë kulturore, zhvillim i mikro-bizneseve dhe para të gatshme për programe të punës (punësimi i përkohshëm).

Sistematikisht, OJQ Mundësia ka përforcuar kapacitetet e veta organizative, si dhe ato të stafit të vet, me qëllim që të jetë në gjendje të ofrojë shërbime cilësore në kontekstin shpejt të ndryshueshëm të Kosovës në përgjithësi, dhe rajonit të Mitrovicës në veçanti. OJQ Mundësia ka reputacionin e një partneri të besueshëm, të aftë për të dhënë shërbime të cilësisë së lartë të menaxhimit të projekteve, përfshirë menaxhimin financiar. OJQ Mundësia i ka dhënë përparësi zhvillimit të vazhdueshëm të cilësisë, për shembull duke hartuar udhëzues për financa dhe për burimet njerëzore për të përkrahë funksionimin.

Strategjia aktuale është formuluar nga stafi i OJQ Mundësia gjatë gjysmës së parë të 2012. Procesi i formulimit ka qenë proces me pjesëmarrje të plotë. Ky proces ofroi një mundësi për stafin që të mësojë s; bashku lidhur me sfidat dhe mundësitë në zhvillim. Si rezultat, stafi është plotësisht i dedikuar ndaj objektivave strategjike të strategjisë, dhe përmbushjes së tyre.

2 Sfidat momentale të zhvillimit

Qeveria e re e Kosovës – me përkrahjen e trupave ndërkombëtare – ka investuar në zhvillimin e një kornize legale të hollësishme. Komplikime dhe sfida mbesin në implementim, meqenëse qeveria ende nuk është në gjendje të ofrojë shërbimet e nevojshme për qytetarët e vet. Një përqindje e madhe e burrave, grave dhe fëmijëve kosovarë vazhdojnë të përballen me shumë sfida ekonomike dhe sociale. Sfidat janë efekt anësor i mos-përfshirjes shoqërore. Ngecja ekonomike vazhdon të mbetet problem, meqë normat e rritjes (ekonomike) kanë mbetur në nivel të ultë. Varfëria është gjerësisht e përhapur në Kosovë, dhe normat e varfërisë janë më të përhapura në rajonet rurale dhe në mesin e grupeve të pakicave. Rajonet e Mitrovicës dhe Ferizajt kanë përqendrimin më të madh të varfërisë në Kosovë. Kosova ka përqindjen më të madhe të papunësisë në Evropë. Rreth 45% e fuqisë punëtore është e papunë. Normat e papunësisë së rinisë mbërrin në 73%, kurse të grave 81%. Cilësia e jetës është e varfër në Kosovë, treguesit e shëndetit janë më të dobët në Evropë dhe cilësia e shkollimit dhe qasjes në shkollim është shumë e lëvizshme. Diskriminimi i pakicave etnike është në përhapje (*UNDP Kosovo Human Development Report 2010*).

Njëjtë, diskriminimi kufizon ashpër kontributin e gruas kosovare. Gratë dhe të rinjtë janë më të dëmtuarit. Gratë përbëjnë më shumë se gjysmën e popullsisë së Kosovës. Shumë njerëz besojnë se gratë e kanë vendin në kuzhinë, derisa burrat janë të destinuar për biznes dhe politikë. Situata është më e keqe në rajonet rurale dhe në qytetet më të vogla. Diskriminimi kundër grave është i përhapur për shkak të statusit të ultë shoqëror, mungesës së shkollimit dhe mungesës së mundësive për punë. Rajonet rurale në regjionin e Mitrovicës janë ende mjaft patriarkale. Normat dominuese kulturore dhe shoqërore përkufizojnë gratë si pjesë të familjeve të burrave të tyre. Pjesë e madhe e problemit është fakti që diskriminimi gjinor është diskutuar vetëm në nivel qendror - në Prishtinë, deri sa efektet e tij ndjehen kryesisht në nivel lokal, në rajone rurale. Në disa fshatra rurale problemi qëndron në faktin që vajzat e reja nuk vazhdojnë shkollimin e mesëm. Pas përfundimit të shkollimit fillor ato qëndrojnë në shtëpi, deri sa të martohen.

Kosova ka popullatën më të re në Evropë (mosha mesatare 23 vjeçare). Të rinjtë, burrat dhe gratë e reja, paraqesin një mundësi, si edhe një sfidë. Rinia shikon përpara dhe ka ide më të qarta se më të vjetrit e tyre, lidhur me atë se si të mobilizohet komuniteti dhe si të bëhen pjesë e vendim-marrjes. Meqë janë rritur në kushte të krizës dhe dhunës, ata nuk kanë përvojë të jetuarit dhe punuarit me grupet tjera etnike. Ekziston një kureshtje e thellë, e ndërsjellë, për grupet tjera etnike – por në veri ka edhe dyshim të rrënjosur thellë, meqë marrëdhëniet në mes të grupeve të ndryshme etnike janë larg nga normalet. Të rinjtë e të gjitha komuniteteve në Kosovë përballen me brenga të zakonshme se si të gjendet punë në një ekonomi në ndryshim, si të përmirësohet cilësia dhe siguria e shkollave të tyre dhe si të adresohen problemet shoqërore.

Sistemi aktual i mbrojtjes shoqërore në Kosovë përbëhet prej ndihmës sociale dhe shërbimet sociale dhe familjare. Ndihma sociale u paguhet familjeve me të ardhura të vogla të cilat plotësojnë kriteret e kërkuara. Shuma e përfitimeve mujore llogaritet në bazë të anëtarëve të kualifikuar të familjes (p.sh. një familje katër anëtarësh do të pranonte 65 EUR në muaj). Pensioni bazë për personat që kanë arritur moshën e pensionimit është 45 EUR në muaj. Qeveria po punon në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore. Shërbimet bazike të kujdesit shëndetësor ekzistojnë në nivel të komunës, por në nivel të fshatrave, shërbimet kanë nevojë për zhvillim të mëtutjeshëm. Për momentin, nuk ekziston ndonjë sistem i përgjithshëm i sigurimit shëndetësor në Kosovë.

Regjioni i Mitrovicës përbëhet nga gjashtë komuna: Mitrovica, Zveqani, Leposaviqi, Skenderaj, Zubin Potoku dhe Vushtrria. Popullata totale është përafërsisht 223,000, e përbërë nga shqiptarët, serbët, boshnjakët, turqit, romët, ashkalinjtë, egjiptianët (RAE) dhe gorani. Komunat e Mitrovicës dhe Vushtrrisë janë qendrat më të mëdha urbane. Ka shumë enklava të pakicave etnike në këto komuna. Mitrovica është etnikisht e ndarë në pjesën serbe dhe atë shqiptare (veriu dhe jugu). Ka gjithashtu edhe boshnjakë, turq, romë, ashkali dhe egjiptianë (RAE), dhe gorani që jetojnë në qytet. Përzierja etnike në komunat tjera në rajon ndryshon nga njëra në tjetrën. Komuna e Zveqanit ka një shumicë të madhe të serbëve të Kosovës, njëjtë si edhe komunat e Leposaviqit dhe Zubin Potokut. Në komunën e Vushtrrisë, shqiptarët etnikë përbëjnë 95% të popullatës. 5% të mbetur janë kryesisht serbë të Kosovës. Komunitetet tjera përfshijnë turqit e Kosovës, romët, ashkalinjtë, egjiptianët dhe qerkezët. Shumica e Personave të Zhvendosur Internal (IDP) janë të vendosur në rajonin e Mitrovicës (*OSCE Municipal Profiles 2011*).

Mitrovica është një nga komunat më të varfra të Kosovës (norma e llogaritur e varfërisë arrin 69%). Situata nuk ndryshon shumë as në komunat tjera. Norma e papunësisë në Mitrovicë është një nga më të lartat në Kosovë. Kjo si pasojë e faktorëve të përzier politikë, ekonomikë, kulturorë dhe socialë. Qyteti i Mitrovicës dhe komunat fqinje janë të njohura si rëndë të ndotura, për shkak të trashëgimisë negative të punëdhënësit kryesor në të kaluarën, minierës Trepça, dhe pajisjeve të saj proceduese, që u mbyllën në fund të nëntëdhjetave.

Tensionet në mes të komuniteteve në Kosovë, dhe posaçërisht në rajonin e Mitrovicës, mbesin të larta. Rajoni është një nga pikat e nxehta të Kosovës. Situata në veri të Kosovës ka qenë e tensionuar nga Qershori 2011 e tutje, kur dhuna mes shqiptarëve dhe serbëve shpërtheu. Tensionet ndërlidhen me planet e qeverisë së Kosovës për të marrë përsipër dy pikëkalimet kufitare veriore me Serbinë. Rrugët për në pjesën veriore kanë qenë të bllokuara qysh nga shtatori 2011, si pasojë e protestave të popullatës serbe kundër institucioneve kosovare. Jeta politike vazhdon të dominohet nga besnikëria ndaj etnisë. Shpresat për pajtim politik dhe shoqëror janë të vogla.

3 Vlerat dhe parimet tona operuese

Mundësia beson në:

- Transparencë dhe mbajtjen e marrëdhënieve të hapura dhe bashkëpunimit me komunitetet, qeverinë dhe partnerët
- Besueshmëria, d.m.th prodhimi i asaj që është premtuar
- Zotim për ofrimin e shërbimeve të cilësisë së lartë
- Besueshmëri të të gjithë anëtarët e komuniteteve
- Trashëgimi të vlefshme
- Fleksibilitet me menaxhmentin dhe stafin.

Principet kyçe të veprimtarisë së OJQ Mundësia janë:

- OJQ Mundësia punëson njerëz me përvojë dhe të kualifikuar të cilët besojnë në punën ekipore dhe në të pasurit e marrëdhënieve të mira të brendshme.
- Punësimi bazohet në nevojat faktike të projekteve, duke u dhënë individëve të zgjedhur një shans për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë.
- OJQ Mundësia është një mundësi e barabartë punësimi – shumica e personave të kualifikuar do të punësohen, pavarësisht gjinisë së tyre, përkatësisë etnike, orientimit seksual ose religjionit. Si pasojë, stafi i OJQ Mundësia është shumë-etnik dhe shumë-gjuhësor. Ata i përkasin të dy gjinive, si edhe komunitetit HLBT.
- OJQ Mundësia aktivisht kërkon partneritet me organizatat tjera të shoqërisë civile dhe mirëpret bashkëpunimin shumë-etnik. Të gjitha komunitetet dhe grupet etnike janë baras të mirëseardhura të punojnë me OJQ Mundësia.
- OJQ Mundësia punon në partneritet edhe me institucionet tjera, siç janë ambasadat, OJQ-të ndërkombëtare, dhe organizatat qeveritare.

4 Vizioni dhe Misioni

Vizioni për zhvillimin e Kosovës i OJQ Mundësia bazohet në qasje të barabartë dhe zhvillim përfshirës, në mënyrë që të gjithë qytetarët mund të ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si pjesëtarë të plotë dhe aktiv të një shoqërie demokratike dhe shumë-etnike.

Misioni i OJQ Mundësia është të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë përmes fuqizimit të grupeve më të pafavorshme, në mënyrë që ato të mund të ushtrojnë plotësisht të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, dhe mund të punojnë në mënyrë efektive drejt përmirësimit të pozitës së tyre shoqërore-ekonomike.

5 Grupet e Synuara dhe rajoni gjeografik

Grupet primare të interesit të OJQ Mundësia paraqesin anëtarët më të varfër dhe më të përjashtuar të shoqërisë kosovare. Ato janë pakicat etnike, gratë rurale, të vejat dhe gratë kryefamiljare, gratë e papunësuar dhe të rinjtë (burra e gra) dhe banorët e enklavave etnike. Gjithashtu, OJQ Mundësia do t'i qaset edhe OJQ-ve dhe shoqërisë civile në përgjithësi. Përderisa më shumë përpjekje janë në drejtim të grave dhe hapësirave rurale, OJQ Mundësia punon me të madhe edhe me komunitetet urbane, p.sh. përkrah burrat e papunësuar urban.

Pakicat etnike (RAE), e posaçërisht romët, vazhdojnë të jetojnë në kushte nën standard, edhe pse me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare shtëpitë dhe banesat u janë rindërtuar. Më shumë se 80% të komunitetit RAE janë të pa-punësuar. Një numër shumë i vogël vazhdon shkollimin e mesëm dhe vetëm një person studion në universitet. Familjet janë të mëdha dhe vajzat e djemtë e rinj martohen shumë herët. Mjerimi nuk zvogëlohet, posaçërisht për gratë dhe familjet e tyre në komunitetin rom që jetojnë në Mëhallën e Romëve në Mitrovicë. Gratë rome janë në përgjithësi më pak të shkolluara, dhe ka një numër të madh të tyre që janë analfabete. Kushtet e tyre çojnë te mundësitë e zvogëluara për punësim, të ardhura më të vogla dhe qasje të limituar në aktivitetet ekzistuese për gjenerimin e të ardhurave.

Gratë dhe familjet e udhëhequra nga gratë kanë një pozitë mjaft të rëndë shoqërore-ekonomike. Shkollimi i ultë e bën punësimin edhe më të vështirë për to. Përkrahja nga qeveria është tepër e kufizuar. Shumica e grave jetojnë nga ndihma sociale.

Banorët e fshatrave të izoluar rurale vuajnë nga infrastruktura e dobët dhe shërbime gati jo-ekzistuese. Përpos ndihmës mujore sociale, gratë rurale kanë një qasje të kufizuar në të holla të gatshme. Mungesa e parave të gatshme kufizon qasjen e tyre në shërbime, p.sh. shëndetësi (për gratë më të vjetra) dhe shkollim (posaçërisht për gratë e reja).

Rinia ka nevojë për përkrahje, në mënyrë që zërat e tyre të mund të dëgjohen dhe të jenë në gjendje të marrin pjesë në proceset vendim-marrëse. Rinia e pa-punësuar (burrat dhe gratë e reja, të moshës 16-25 vjeç) kanë nevojë për vëmendje dhe përkrahje urgjente. Mundësitë e punësimit dhe sigurimit të jetesës për gratë e reja janë tepër të kufizuara. Ato janë të kufizuara posaçërisht për ato gra të reja të cilat nuk janë në pozitë të vazhdojnë shkollimin e mesëm. Shkollat e mesme nuk janë të vendosura në fshatra dhe familjet mund të kenë probleme në financimin e transportit shkollor, bile edhe për vajzat me nota të mira. Anësimi gjinor mund të kontribuojë gjithashtu. Mundësitë për punësim fitimprurës janë të limituara edhe për meshkujt e rinj të shkolluar, për shkak të perspektivës së varfër të regjionit. Së këndejmi, meshkujt dhe femrat e reja nuk kanë ndonjë vizion për të ardhmen e tyre, edhe pse janë të gatëm për të hyrë në fuqi punuese dhe për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë.

Enklavat kanë ekzistuar në Kosovë që nga përfundimi i konfliktit më 1999. Ato banohen kryesisht nga pakicat, në rajon të populluar me shumicë. Liria e lëvizjes të komuniteteve të ndryshme të enklavave është përmirësuar që nga përfundimi i konfliktit, por është ende e pakënaqshme. Komuniteti i donatorëve nuk po punon me komunitetet e enklavave, siç ishte rasti në vitet pas konfliktit.

Shoqëria civile në Kosovë ende nuk është mirë e formësuar. Edhe pse ka mbi 4,500 OJQ zyrtarisht të regjistruara, vëzhguesit llogarisin se vetëm rreth treqind janë aktive, përfshirë këtu edhe organizatat e fokusuara në ofrimin e shërbimeve, zhvillim të komuniteteve dhe/ose avokim të politikave. Në përgjithësi, shoqëria civile e ditëve të sotme karakterizohet me nivel të ultë të mobilizimit të resurseve njerëzore, udhëheqësi të dobët dhe lidhje të dobëta me zgjedhjet e qytetarëve. Ekziston një pamundësi e përgjithshme, për arsye historike dhe politike, për të realizuar aso pune të shoqërisë civile, që do të krijonte lidhje përtej ndarjeve etnike. Gjithashtu, në shoqërinë kosovare ka një nivel të ultë të pranimit publik të OJQ-ve dhe punës së tyre. Kjo, në masë të madhe për shkak të keqkuptimeve publike për punën e OJQ-ve dhe si ato menaxhohen. Organizatat e shoqërisë civile kanë një potencial shumë të kufizuar për t'u bërë financiarisht të pavarura, pa përkrahjen e donatorëve ndërkombëtarë. Në rajonin e Mitrovicës, ka rreth 400 OJQ të

regjistruara, përderisa vetëm rreth 20 janë momentalisht aktive. Shumica e OJQ-ve aktive janë OJQ të vogla lokale, që punojnë vetëm në 1 a 2 çështje.

Një grup i veçantë i interesit janë anëtarët e OJQ Mundësia. Janë rreth 140 anëtarë të paguar, që jetojnë në qytetet e Mitrovicës dhe Vushtrrisë, dhe disa në fshatrat përreth. Shumica prej tyre janë anëtarë të ish-grupeve të interesit të projekteve të kaluara. Prandaj ata përfaqësojnë rrënjët e organizatës. OJQ Mundësia u ofron këtyre grave qasje në tregun e artizanëve tradicionale dhe mundësi për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme që OJQ Mundësia i organizon. Anëtarët ndajnë lidhje të thella emocionale me OJQ Mundësia.

Gjatë periudhës së strategjisë, OJQ Mundësia do të fokusojë aktivitetet e veta në komunat e regjionit të Mitrovicës (Leposaviq, Mitrovicë (jug dhe veri), Skenderaj, Vushtrri, Zubin Potok and Zveçan). Rreth 95% të burimeve do të ndahen për këto rajone gjatë periudhës së strategjisë. Sido që të jetë, OJQ Mundësia gjithashtu do të shikojë shanset që gjatë kësaj periudhe të strategjisë të zgjerohet edhe në 1 a 2 regjione tjera në Kosovë. Ka shumë të ngjarë që diku 5% të burimeve të drejtohen drejt këtyre regjioneve gjeografike.

6 Çështje strategjike

Gjatë procesit të formulimit të strategjisë, një numër i madh i problemeve dhe çështjeve të shoqërisë në Kosovë dhe Mitrovicë janë diskutuar dhe analizuar. Katër prej tyre (më poshtë) u dalluan si çështje kyçe në të cilat OJQ Mundësia duhet të punojë gjatë kësaj periudhe strategjike. Përzgjedhja e tyre u ndikua nga ashpërsia e problemeve, dhe nga përvoja e mëhershme e OJQ Mundësia, si edhe nga fuqitë dhe ekspertiza për të kontribuar drejt zgjidhjeve të qëndrueshme.

Çështja 1: Pajtim dhe integrim i pakicave i pa përfunduar

Konflikti i dhunshëm ka përfunduar para më shumë se dhjetë vitesh. Përkundër aktiviteteve të shumta dhe përpjekjeve nga ana e bashkësisë ndërkombëtare (UNMIK, KFOR, EULEX, OSCE dhe lojtarët tjerë) në të kaluarën, dhe së fundmi edhe nga institucioneve qeveritare të Kosovës së pavarur, pakicat etnike ende nuk mund të shprehen lirshëm, si pasojë e ndarjeve politike dhe etnike. Ekziston pak (në disa raste aspak) tolerance për komunitete të ndryshme. Për momentin, OJQ-të tjera nuk janë të interesuara të implementojnë projekte shumë-etnike. Ka mungesë të bashkëpunimit në mes të grupeve etnike. Hapësira punuese nuk është e favorshme për punë të përbashkët të shqiptarëve dhe serbëve. Përkundër përmirësimeve në situatën e sigurisë, shumë komunitete që jetojnë në enklava ende nuk bashkëveprojnë rregullisht me fqinjët e tyre që përfaqësojnë grupe të ndryshme etnike. Shumëllojshmëria religjioze nuk çmohet. Shkollat nuk ua mësojnë më gjuhën serbe shqiptarëve, e as gjuhën shqipe serbëve, çka ka sjell deri te problemet me gjuhë dhe komunikim, sidomos mes moshave të reja. Vëmendja e mediejeve për promovimin e paqes dhe pajtimit është zvogëluar, për dallim nga e kaluara. Lëvizja përmes regjionit të Mitrovicës nuk është e lirë. Statusi i pazgjidhur i veriut të Kosovës, bashkë me acarimin e konfliktit lokal në rajonin e Mitrovicës (barrikadat e vendosura qysh nga mesi i 2011) si dhe trashëgimia e rëndë e historisë, pengojnë seriozisht arritjen e paqes në veri. Kushtet ekonomike janë të rënda pasi që ka nivel të ultë të investimeve, dhe nivel të lartë të papunësisë. Këto kontribuojnë në problemet politike dhe ekonomike, meqë njerëzit nuk kanë pikëveshtrim pozitiv për të ardhmen e tyre.

Çështja 2: Zhvillim ekonomik dhe mundësi punësimi të limituara për të rinj, gra dhe burra

Kosova si shtet ende gjendet në fazën e komb-ndërtimit. Qeveria e Kosovës orvatet të zhvillojë kornizë politike të favorshme dhe të instalojë një kornizë legale gjithë-përfshirëse, e cila është e nevojshme për të përkrahur sipërmarrjet. Deri më tani, vetëm disa nga politikat dhe ligjet implementohen në praktikë. Ka mungesë të investimeve direkt nga jashtë dhe barrierat për eksport dhe import kufizojnë transaksionet ekonomike. Një faktor kontribuues është edhe fakti që pavarësia e Kosovës është vetëm pjesërisht e pranuar. Rrjedhimisht, Kosova nuk ka qasje në Organizatën Botërore të Tregtisë – WTO (edhe pse është anëtare e Bankës Botërore), ose në instrumentet tjerë ndërkombëtarë që lehtësojnë zhvillimin ekonomik. Korrupsioni është identifikuar si një nga problemet kryesore, si në institucionet publike ashtu edhe në ato private. Me burime të limituara lokale, qeveria e Kosovës nuk është në gjendje të investojë në mënyrë domethënëse. Në nivel lokal, aftësitë për përkrahjen e ekonomisë janë zhvilluar, por nuk janë ende efektive. Problemet në nivel kombëtar vijnë më shumë në shprehje në rajonin e Mitrovicës. Para luftës, Mitrovica ishte një qytet industrial. Rajoni nuk u këndell në aspektin ekonomik qysh nga mbyllja e minierës së Trepçës, si edhe

departamenteve për procesim të xehes. Skenari i paqartë lidhur me veriun e Kosovës (çështja 2) duket se do të vazhdojë të dekurajojë investimet në regjion, edhe në të ardhmen e afërt. As sistemi shkollor nuk është i organizuar drejt prodhimit të të certifikuarve me aftësi të përshtatshme për tregun e punës. Të rinjtë e diplomuar, edhe pse me nota të mira dhe të certifikuar, po hasin në vështirësi për t'u kyçur në tregun e punës. Situata është edhe më e rëndë për të rinjtë të cilët kanë përfunduar vetëm shkollimin fillor ose atë të mesëm, ose që kanë lënë shkollën. Për gratë, mundësitë janë edhe më të pakta.

Çështja 3: Mungesa e interesit për trashëgimi kulturore dhe vetëdijesim i ultë për kulturat e grupeve tjera etnike

Komunitetet e grupeve të ndryshme etnike nuk brengosen fort për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore të të tjerëve (sinagogat, xhamitë, oborret e kishave, monumentet, etj). Posaçërisht të rinjtë kanë njohuri shumë të limituara për kulturat tjera dhe pak vlerësim për të tjerët. Mungesa e respektit të ndërsjellë për trashëgimi kulturore të grupeve tjera etnike është e zakonshme, duke rezultuar bile edhe me shkatërrimin e varrezave dhe objekteve të vlerave fetare. Trashëgimia shpirtërore dhe natyrore e Kosovës nuk është nën kujdes dhe komunitetet kanë vetëdijesim të ultë për rëndësinë e tyre. Kjo gjithashtu është çështje që nuk listohet lartë në agjendën e qeverisë e as të lojtarëve tjerë të shoqërisë civile.

Çështja 4: Efektivitet i ultë i aktiviteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile

Si rezultat i shënimeve të dobëta të shumë OJQ-ve të themeluara pas luftës, organizatat e shoqërisë civile kanë një imazh dhe reputacion të keq në Kosovë. Puna e shumicës prej OJQ-ve ekzistuese është e pamjaftueshme dhe shpesh jo-efektive – nuk qon te rezultatet e dukshme. Për shembull, OJQ-të kanë aftësi dhe kapacitete të dobëta në zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve. Sido që të jetë, OJQ Mundësia shihet me sy tjetër dhe shumë OJQ i janë qasur OJQ Mundësia duke kërkuar përkrahje në ngritjen e kapaciteteve të veta.

7 Qëllimet strategjike dhe strategjitë thelbësore

Më poshtë janë të paraqitura katër qëllimet strategjike të OJQ Mundësia dhe strategjitë kryesore për secilin prej qëllimeve për tri vitet e ardhshme.

Qysh nga fillimi, OJQ Mundësia ka punuar me të gjitha grupet etnike që jetojnë në Kosovë, përmes projekteve të ndryshme. Një nga principet tona operuese është që të punojmë me të gjitha grupet etnike. Kjo punë ka dëshmuar të qoj drejt pajtimit dhe integritit të pakicave.

Qëllimi Strategjik 1: Përmirësim i pajtimit dhe integritit të pakicave

Strategjitë thelbësore

- Organizimi i vizitave studimore, aktiviteteve dhe vizitave të përbashkëta për të rinj dhe grupe të ndryshme etnike (burra e gra)
- Organizimi i punëtorive për dialog ndër-etnik me të rinj, gra dhe burra; organizimi i debateve me grupe të ndryshme etnike në temën e ‘*paqes dhe tolerancës*’
- Inkurajimi i komuniteteve të ndryshme për të filluar planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe realizimin e programeve për ngritjen e vetëdijes për mundësitë e projekteve të përbashkëta; përkrahja posaçërisht për rininë shqiptare dhe serbe për fillimin e bizneseve të përbashkëta.
- Përkrahja e fuqizimit të Rrjetit të Grupeve Shumë-etnike të Grave; përkrahja e formimit të rrjetit rinor shumë-etnik.

Kosova ka popullatën më të re në Evropë dhe vuan nga një normë shumë e lartë e papunësisë (burrat, gratë dhe të rinjtë). OJQ Mundësia e sheh që mund të kontribuojë në përmirësimin e kësaj situatë me përfshirjen e grave dhe të rinjve (burrave dhe grave) në komunitetet e veta. OJQ Mundësia do të vazhdojë të harmonizojë barazinë gjinore dhe ekonomike në të gjitha aspektet e shoqërisë Kosovare duke rritur fuqizimin ekonomik dhe shoqëror të grave, të rinjve dhe burrave në rajonin e Mitrovicës.

Qëllimi Strategjik 2: Zhvillim ekonomik i përmirësuar dhe mundësi punësimi për të rinjtë, gra dhe burra

Strategjitë thelbësore

- ofrimi i trajnimeve në menaxhim të bizneseve dhe në udhëheqjen e bizneseve të ndryshme; ofrimi i trajnimeve për aftësi pune dhe lehtësimi i mundësive sipërmarrëse për anëtarët e grupit të interesit.
- Shpërndarja e informatave dhe tregimeve të suksesshme përmes medieve lokale (radio, TV, media të shkruara)
- Përkrahja dhe lehtësimi i qasjes së përmirësuar të të rinjve (mosha 15 deri 25 vjet) në fitimin e stazhit me institucionet publike dhe private
- Ofrimi i biznes granteve afat-shkurta për përkrahjen e formimit të sipërmarrjeve dhe zhvillimin e mikrobizneseve; përkrahja e krijimit të grupeve prodhuese.
- Ndërlidhja dhe avokimi me trupat lokale qeveritare, OJQ-të dhe projektet e tjera për përmirësimin e qasjes së grupeve të interesit të skemat ekzistuese përkrahëse dhe të dhëna për prodhimtari.
- Organizimi i kurseve të ndryshme trajnuese për aftësi (gjuhë angleze, aftësi kompjuterike, aftësi për punë, floktari, qepje, prodhimtari qumështore, furrtari, artizanat etj) për grupe të ndryshme të interesit.

OJQ Mundësia e sheh promovimin e trashëgimisë kulturore të të gjitha grupeve etnike që jetojnë në Kosovë si të rëndësishme edhe për paqen dhe pajtimin. Aq më shumë, kjo është një çështje që për momentin nuk zgjon interesim të madh të organizatave të shoqërisë civile ose lojtarëve qeveritarë.

Qëllimi Strategjik 3: Rritja e interesit dhe vetëdijesim i përmirësuar lidhur me trashëgiminë kulturore dhe traditat e të gjitha grupeve etnike

Strategjitë thelbësore

- Organizimi i kampanjave të vetëdijesimit për mbrojtjen e kulturës dhe trashëgimisë
- Avokim dhe bashkëpunim i afërt (mundësisht mobilizim i resurseve) me Grupin Punues ndër-sektorial (Komunal dhe atë Rajonal) në implementimin e projekteve për promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
- Promovimi i trashëgimisë shpirtërore me të rinjtë e të gjitha grupeve etnike përmes vizitave, sesioneve dialoguese dhe ligjëratave.
- Organizimi i panairëve të trashëgimisë në Kosovë, dhe pjesëmarrja në panairët e trashëgimisë në shtetet tjera të rajonit; organizimi i vizitave studimore dhe ekskursioneve të monumentet e ndryshme kulturore, me grupe të ndryshme etnike; organizimi i tryezave të rrumbullakëta, seminare me grupe të ndryshme etnike për shkëmbimin e ideve lidhur me trashëgiminë kulturore.

OJQ Mundësia beson në forcimin e lidhjeve dhe partneritetit me organizatat ndërkombëtare dhe lokale, qeverinë dhe sektorin privat, për të shtyrë përpara qëllimet e zhvillimit të shoqërisë civile. OJQ Mundësia do të vazhdojë të përkrahë OJQ-të e grave dhe të rinjve të përkatësive Rome, ashklike, serbe, boshnjake dhe turke. Gjatë periudhës së strategjisë, përkrahja fokusohet sidomos te OJQ-të e rajonit të Mitrovicës.

Qëllim Strategjik 4: Efektivitet i përmirësuar i aktiviteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile

Strategjitë thelbësore

- Projektet e përbashkëta
- Ofrimi i trajnimeve për menaxhment dhe ngritja e kapaciteteve të stafit, aftësi udhëheqëse dhe shkrimi i projekt propozimeve
- Organizimi i vizitave studimore
- Lehtësimi dhe qasja e OJQ-ve lokale tek komuniteti i donatorëve

Ka disa tema që ndërthuren dhe rrjedhin përgjatë këtyre qëllimeve. Ato përfshijnë theksimin e inkurajimit të stabilitetit ndër-etnik, zhvillimi dhe integrimi i të gjitha grupeve etnike në shoqëri. Fuqizimi i grupeve të pafuqishme gjendet në të gjitha qëllimet strategjike, njëjtë si edhe çështjet e barazisë gjinore.

8 Palët e Përfshira, partneritetet dhe rrjetëzimi

OJQ Mundësia do të vazhdojë të punojë krahas, dhe në bashkëpunim me, OJQ-të ndërkombëtare, OJQ-të, institucionet qeveritare, bizneset, rrjetat dhe lojtarët tjerë relevantë që punojnë në zhvillimin e shoqërisë civile për të identifikuar financime, përkrahje në të mira, ose sponsorim për projektet e veta. OJQ Mundësia gjithashtu do të kërkojë bashkëpunim të ngushtë me organizatat e të njëjtës filozofi, me të cilat ndajmë vizionin dhe objektivat. OJQ Mundësia gëzon bashkëpunim të mirë dhe marrëdhënie punuese me OJQ-të e grave serbe, boshnjake, rome dhe turke, që punojnë në Mitrovicë (jug dhe veri).

Të identifikuarit si partnerë kryesorë, bashkë me palët kyçe të përfshira për secilin qëllim strategjik janë listuar më poshtë (Tabela 1). OJQ Mundësia vazhdon të forcojë rrjetin e vet dhe mirëpret partnerë të rinj të cilët dëshirojnë të kontribuojnë drejt synimeve të përbashkëta.

Tabela 1. Partnerët dhe Palët e Interesuara Kyçe për secilin Qëllim Strategjik

Qëllimi Strategjik	Partnerët kryesorë	Palët e Përfshira
Qëllim strategjik 1: Përmirësim i pajtimit dhe integrimi i pakicave	<ul style="list-style-type: none"> • <i>FinnChurchAid</i> dhe <i>Church of Sweden</i>: Programi Ndër-Etnik i Fuqizimit të Komuniteteve (partner edhe për QS2 dhe QS3) • <i>Danish Refugee Council</i> – Fuqizimi i komunitetit RAE • Shoqata e Grave Serbe të Biznesit (WBA, partner dhe për QS2): OJQ Mundësia menaxhon Biznes-Qendrën Rinore të Komunitetit në Mëhallën e Boshnjakëve në veri të Mitrovicës, në partneritet me WBA • Gratë Rome për Gratë Rome (OJQ lokale e grave në Mitrovicë): implementimi i projekteve të përbashkëta me qëllim të fuqizimit të grave rome, përmes dialogut ndër-etnik dhe integrimi i tyre në projekte të përbashkëta. • MEDICOR: Kujdes shtëpiak për të vjetrit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ministritë relevante • Autoritetet Komunale • Media • Zyra komunale e komuniteteve • Oficeri komunal për kthim • Institucionet publike dhe private shëndetësore • OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare.
Qëllim strategjik 2: Zhvillim ekonomik i përmirësuar dhe mundësi punësimi për të rinjtë, gratë dhe burrat.	<ul style="list-style-type: none"> • Qeveria Belge: Biznes-Qendra Rinore e Komunitetit në Mëhallën e Boshnjakëve, Mitrovica veriore • USAID: Punësim i përkohshëm për të rinjtë, përkrahja e bizneseve të vogla, çështje mjedisore • OJQ lokale IADK: Organizimi i trajnimeve për bujqësi. • REA Prishtina 	<ul style="list-style-type: none"> • Ministritë relevante • Autoritetet Komunale • Media • Qendra rajonale për punësim • Sektori privat (bizneset) • Sektori publik (gjetja e vendeve të punës) • OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare.
Qëllim strategjik 3: Rritje e interesimit dhe vetëdijesim i përmirësuar lidhur me trashëgiminë kulturore dhe traditat e të gjitha grupeve etnike.	<ul style="list-style-type: none"> • Këshilli i Evropës: Promovimi i Shumëllojshmërisë Kulturore të Kosovës. • OJQ Sabor: Organizimi i trajnimeve dhe prodhimi i artizaneve, në drejtim të ruajtjes së trashëgimisë kulturore të Kosovës. • OJQ Emina: Organizimi i trajnimeve për edukim dhe shëndet dhe prodhimi i artizaneve, me qëllim të trashëgimisë kulturore të Kosovës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ministritë relevante • Autoritetet Komunale • Media • Qendra për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore (kombëtare dhe rajonale) • Muzetë • Grupet punuese për shumëllojshmëri kulturore, rajonale dhe komunale.

Qëllimi Strategjik	Partnerët kryesorë	Palët e Përfshira
		<ul style="list-style-type: none"> OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare.
Qëllim strategjik 4: Efektivitet i përmirësuar i aktiviteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile	<ul style="list-style-type: none"> Rrjeti i Grave të Kosovës Shoqata e Grave Kosovare të Biznesit. OJQ lokale e grave 2 KORRIKU: Implementimi i kurseve të shkrim-leximit dhe trajnime për shëndetin në rajonin e Mitrovicës. OJQ Dera e Hapur: Ngjarje kulturore OJQ Prehja: Organizim i trajnimeve për shoqërinë civile në komunën e Skenderajt. OJQ Jak dhe Syri i Rinisë: Organizim i trajnimeve dhe punëtorive për fëmijë dhe rinj. 	<ul style="list-style-type: none"> Media OJQ-të tjera Zyra ndërlidhëse e OJQ-ve OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare

9 Analizë e Burimeve

Kapacitetet e organizatës - Forcat

Ka katër komponentë kyç që do ta bëjnë Mundësinë organizatë të suksesshme edhe në të ardhmen:

- Mision dhe Vizion i qartë për të ardhmen
- Udhëheqje e fortë
- Rrjet i gjerë shumë-kulturore dhe ndër-sektorial i partnerëve të besueshëm.
- Njohuri dhe dijeni e gjerë.

Ne do të ruajmë fuqitë tona dhe do të vazhdojmë t'i zhvillojmë ato tutje. Ato janë:

- OJQ Mundësia ka njëmbëdhjetë vite përvojë të implementimit të suksesshëm të projekteve gjithnjë e më të ndërlikuara dhe më sfiduese, në një kontekst mjaft sfidues.
- Zyrat mirë të furnizuara, pajisje dhe metoda pune për të zhvilluar punën në teren.
- Staf me përvojë, shumë-etnik dhe shumë-gjuhësor, me përfaqësim të të dy gjinive.
- Kapacitet të dëshmuar për të menaxhuar projekte të shumëllojshme që shtrihen nga programet afat-shkurta “para të gatshme” deri te projektet shumë-vjeçare zhvillimore që kanë për qëllim ndikim zhvillimor afat-gjatë.
- Menaxhmenti dhe sistemi operativ, si dhe manualët e ripërtërirë janë organizuar. Sistemet tona financiare përfshijnë program profesional kompjuterik. Jemi të vendosur të mbajmë llogari të sakta dhe të prodhojmë raporte që kënaqin kërkesat e partnerit. Llogaritë e OJQ Mundësia auditohen çdo vit.
- Sistem i fuqishëm i Planifikimit të Projekteve, Menaxhmentit dhe Vlerësimit (PME), që përkrahë mësimin dhe zhvillim të vazhdueshëm të kapaciteteve të veta. Jemi në gjendje të aplikojmë Menaxhmentin e Bazuar në Rezultate (RBM) në projektet tona.
- Të gjitha grupet etnike e njohin OJQ Mundësia si një partner të besueshëm – njëjtë edhe gratë, të rinjtë – dhe në rritje është gjithashtu numri i burrave – në rajonin e Mitrovicës. OJQ Mundësia ka reputacionin e një OJQ-je që punon për njerëzit, prandaj edhe ka besimin e grupeve të interesit.

Mësimi dhe bonifikimi

Kemi identifikuar një numër të hapësirave ku kemi nevojë të forcojmë kapacitetet tona edhe më tutje, me qëllim që të jemi në pozitë që në mënyrë efektive të punojmë drejt përbushjes së misionit dhe qëllimeve tona strategjike. Kemi njohur rëndësinë që ka për OJQ Mundësia vazhdimi i investimeve në mësim. Fushat kryesore për mësim dhe përmirësim gjatë periudhës së strategjisë do të përfshijnë:

- Qasje e bazuar në të drejtën (RBA) për zhvillim
- Qasje fuqizuese
- Qasje gjinore
- Gjenerimi i mjeteve të jetesës dhe të ardhurave
- Bashkë-financimi i komuniteteve
- Biznes planet dhe mikro-bizneset
- Ngritja e fondeve
- Statusi i OJQ Mundësia nga viti 2001 do të rishikohet për të siguruar që dispozitat janë të vlefshme dhe plotësisht përkrahin arritjen e qëllimeve strategjike.

Gjatë gjysmës së dytë të 2012, një vlerësim më i detajuar i kapaciteteve të stafit do të zhvillohet, me qëllim të identifikimit të burimeve ekzistuese njerëzore dhe boshllëqet aty. Një plan për zhvillimin e kapaciteteve do të hartohet. Implementimi i planit do të kërkojë burime si nga OJQ Mundësia ashtu edhe nga partnerët e vet.

Burimet

OJQ Mundësia hyn në periudhën e strategjisë së re me pozicionim të fortë. Qysh gjatë 2010 – gjysma e 2012, investim i rëndësishëm ka ndodh në fuqizimin e kapaciteteve organizative të OJQ-së. Manualë të ri-përtërirë janë zhvilluar, dhe është krijuar program profesional kompjuterik për kontabilitet. Sistemet administrative dhe menaxhuese të OJQ-së janë të fuqishme dhe të afta për të menaxhuar portfolion në rritje të projekteve. OJQ Mundësia operon nga zyra në pronësi të vet dhe posedon një eskadër automjetesh. Njëjtë, investime në ngritjen e kapaciteteve të stafit tashmë kanë ndodhur. Rishtas, p.sh. stafi ka fituar aftësi të reja në Menaxhmentin e Bazuar në Rezultate (RBM). Janë prezantuar përmirësimet në sistemet e Planifikimit, Monitorimit dhe Vlerësimit të OJQ Mundësia. OJQ Mundësia ka mundësinë fizike dhe pajisjet, si dhe aftësitë profesionale dhe njohuritë, për të implementuar projekte në kushte që kërkojnë angazhim, si në rajonet rurale, ashtu edhe në ato urbane të Kosovës.

Në fillim të periudhës strategjike, OJQ Mundësia ka mobilizuar tashmë shuma të konsiderueshme të burimeve financiare nga partnerët, për secilin qëllim strategjik (Tabela 2). OJQ Mundësia do të vazhdojë ngritjen aktive të fondeve, për të zgjeruar aktivitetet e veta dhe për të qenë në gjendje të përkrahë grupe më të mëdha të interesit në të ardhmen.

10 Procesi i ri-shikimit të strategjisë

Një rishikim i rregullt i strategjisë është i nevojshëm, për të siguruar që strategjia mbetet e vlefshme për organizatën. OJQ Mundësia do të rishikojë strategjinë një herë në vit, për shembull, e ndërlidhur me zbythjen vjetore të stafit (retreat). Gjatë rishikimit, do të adresohen arritjet e lidhura me qëllimet strategjike dhe ndryshimet në kontekstin operativ. Mësimet e nxjerra gjatë vitit gjithashtu do të diskutohen dhe analizohen. Strategjia do të ripunohet nëse të gjeturat e procesit të rishikimit sugjerojnë të njëjtën..

OJQ Mundësia do të udhëheq një vetë-vlerësim në drejtim të arritjeve të veta, ndërlidhur me qëllimet strategjike dhe hapësirat për zhvillim të kapaciteteve në 2015. Bazuar në gjetjet e vetë-vlerësimit, OJQ Mundësia do të formulojë një strategji të korrigjuar për periudhën e ardhshme.